

L I G J
Nr.8108, datë 28.3.1996

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 “PËR SHOQËRITË TREGTARE”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7953, DATË 21.6.1995**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ndryshuar me ligjin nr.7953, datë 21.6.1995, pas nenit 197 shtohet neni 197/1 me këtë përmbajtje:

“Të gjitha shoqëritë anonime që kanë mbi 50 aksionerë ose janë të regjistruara në një treg të letrave me vlerë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të mbajnë regjistrin e aksioneve në një qendër të pavarur, të specializuar për regjistrimin e aksioneve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Të gjitha transaksionet e kryera me aksionet e shoqërive, të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, do të bëhen nëpërmjet qendrës së pavarur ku ato kanë regjistruar aksionet e tyre.

Marrëdhëniet ndërmjet qendrës së pavarur të regjistrimit të aksioneve dhe shoqërive anonime rregullohen me kontrata”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1462, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha